



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“MULTIMEDIA”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

T/4-IV-25

Tiranë më, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	5
Kodi	5
Kohëzgjatja	5
Qëllimi:	5
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	5
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	5
Ofruesit	5
Data e validimit.....	5
Data e miratimit	5
Variantet e mëparshme	5
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	6
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME (qëndrimet)	6
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:.....	6
NjN-19-IV-0393-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në multimedia.....	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	7
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-19-IV-0394-25 Pajisjet kompjuterike dhe komponentët	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-19-IV-0395-25 Bazat e rrjetit të komunikimit.....	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	10
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-19-IV-0396-25 Bazat e programimit në web dhe sistemet e menaxhimit të përmbajtjes.....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	11
Kriteret e vlerësimit:	12
NjN-19-IV-0397-25 Sistemet e operimit dhe programet aplikative.....	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-19-IV-0398-25 Konceptimi i projektit në multimedia	13

Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	14
Kritere e vlerësimit	14
NjN-19-IV-0399-25 Dizajni grafik.....	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	15
Kriteret e vlerësimit	16
NjN-19-IV-0400-25 Realizimi i animacioneve	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	17
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-19-IV-0401-25 Realizimi i fotove	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	19
Kriteret e vlerësimit	20
NjN-19-IV-0402-25 Realizimi i video-ve	21
Rezultatet e të nxënit në njohuri	21
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	22
Kriteret e Vlerësimit	22
NjN-19-IV-0403-25 Realizimi i audio-ve Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	23
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	24
Kriteret e vlerësimit	24
NjN-19-IV-0404-25 Mediat Digjitale, Tradicionale dhe Përmbajtja.....	25
Rezultatet e të nxënit në njohuri	25
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	26
Kriteret e vlerësimit.....	26
NjN-19-IV-0405-25 Produkti multimedial për prodhim dhe publikim.....	27
Rezultatet e të nxënit në njohuri	27
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	28
Kriteret e Vlerësimit	28
NjN-19-IV-0406-25 Përdorimi i IA për proceset e punës në multimedia.....	28
Rezultatet e të nxënit në njohuri	28
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	29
Kriteret e vlerësimit	29

NjN-19-IV-0407-25 Politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit.....	30
Rezultatet e të nxënit në njohuri	30
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	30
Kriteret e vlerësimit	31
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	31
Rezultatet e të nxënit në njohuri	31
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	32
Kriteret e vlerësimit	32
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	33
Rezultatet e të nxënit në njohuri	33
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	33
Kriteret e vlerësimit	33
NjN-19-IV-0408-25 Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit	34
Rezultatet e të nxënit në njohuri	34
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale.....	34
Kriteret e vlerësimit	35
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:.....	35
Modalitetet e vlerësimit	36
Informacion shtesë	36
SHËNIM	37
Akronime	37

Emërtimi i kualifikimit	Multimedia			Kodi
Kohëzgjatja	4200-6000 orë nacionale	Niveli	IV në KSHK referuar nivelit IV të KEK	T/4-IV-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Multimedia”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre në nivelin e teknikut për multimedia, për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe kryesisht në fushën e multimedias.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Multimedia” të nivelit të katërt në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin 9-vjecar; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Multimedia”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të teknikut të mesëm në këtë fushë. Pas nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, ai/ajo fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare. Ky kualifikim i jep mundësinë individit të hyjë në tregun e punës për t’u punësuar ose vetëpunësuar si teknik multimedia pranë studiove grafike dhe kreative, kompanive mediatike dhe të marketingut, agjencive të reklamës, kompanive të zhvillimit të website-ve dhe aplikacioneve, studiove të produksionit audio-vizual, industrisë së printimit, si dhe institucioneve dhe bizneseve të madhësive të ndryshme. Përveç punësimit tradicional, individit ka mundësi të ofrojë shërbime kreative edhe në mënyrë të pavarur dhe online.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	<i>Dhjetor 2025</i>			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional "Multimedia" niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME (qëndrimet)

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-19-IV-0393-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në multimedia

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë strukturën organizative të biznesit dhe mënyrat e komunikimit hierarkik.

2. Të shpjegojë parimet bazë të legjislacionit të punës dhe atij tatimor që lidhen me aktivitetet profesionale.
3. Të interpretojë detyrat dhe dokumentet e punës sipas kërkesave të projektit.
4. Të argumentojë rëndësinë e leximit dhe interpretimit të dokumentacionit teknik për planifikim dhe organizim.
5. Të shpjegojë rëndësinë e diskutimit në mënyrë profesionale me anëtarët e ekipit për detyrat dhe afatet.
6. Të shpjegojë rëndësinë e përcjelljes qartë të informacionin teknik te kolegët dhe mbikëqyrësit.
7. Të shpjegojë rëndësinë e pranimit dhe dhënies së feedback konstruktiv në përmirësimin e punës.
8. Të klasifikojë llojet e burimeve për realizimin e një projekti;
9. Të klasifikojë llojet e materialeve duke shpjeguar karakteristikat dhe përdorimet e tyre.
10. Të listojë llojet e mjeteve të punës duke shpjeguar funksionimin e tyre;
11. Të rendisë hapat kryesorë të planifikimit të burimeve në një projekt;
12. Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit të kohës së nevojshme për detyra të ndryshme në mënyrë efikase;
13. Të përshkruajë metodat e monitorimit të veprimtarive gjatë procesit të punës;
14. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit ergonomik të vendit të punës për siguri dhe efektivitet;
15. Të dallojë teknikat dhe formatet e ndryshme të raportimit dhe përdorimit të tyre në situata pune;
16. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të platformave tregtare të aseteve digjitale të gatshme për realizimin e projekteve multimediale;
17. Të shpjegojë mënyrat e mbledhjes së informacioneve për të hartuar raporte të sakta;
18. Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes dhe administrimit të dokumentacionit dhe arkivës së organizatës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë strukturën organizative të biznesit dhe mënyrat e komunikimit hierarkik;
2. Të zbatojë parimet bazë të legjislacionit të punës dhe atij tatimor që lidhen me aktivitetet profesionale;
3. Të përcaktojë detyrat dhe dokumentet e punës sipas kërkesave të projektit;
4. Të lexojë dhe interpretojë të dokumentacionit teknik për planifikim dhe organizim;
5. Të bashkëpunojë në mënyrë profesionale me anëtarët e ekipit për detyrat dhe afatet;
6. Të pranojë dhe japë feedback konstruktiv në përmirësimin e punës;
7. Të planifikojë llojet e burimeve (materiale, njerëzore dhe financiare) për realizimin e një projekti;
8. Të përzgjedhë mjetet e punës sipas funksionimit të tyre;
9. Të menaxhojë burimet e një projekti;
10. Të përdorë asete digjitale të gatshme nga platforma tregtare në projekte multimediale;
11. Të kryejë planifikimin dhe menaxhimin e kohës së nevojshme për realizimin e detyra në mënyrë efikase;
12. Të përcaktojë hapat për mbikëqyrjen e ecurisë së një projekti sipas afatit kohor dhe cilësisë;

13. Të zbatojë praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
14. Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës për siguri dhe efektivitet;
15. Të hartojë dokumentacion teknik dhe operacional sipas proceseve të punës;
16. Të hartojë raporte të ndryshme sipas formateve të dhëna.
17. Të kryejë mirëmbajtjen dhe administrimin në mënyrë korrekte të dokumentacionit dhe arkivës e organizatës.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh organigramën dhe strukturën organizative sipas llojit të biznesit;
- Përcakton nivelet e përgjegjësisë dhe kanalet e komunikimit hierarkik sipas politikave të kompanisë.
- Specifikon rolet dhe funksionet kryesore brenda ekipit sipas rregullores së brendshme;
- Identifikon detyrimet të punëmarrësit dhe punëdhënësit sipas legjislacionit;
- Lexon dhe interpreton dokumentet dhe udhëzimet teknike të punës;
- Përdor mjete digjitale për koordinim dhe menaxhim detyrash sipas projekti dhe rregullores së brendshme;
- Vizaton ose skicon elemente teknike për qartësim të informacionit në varësi të projektit;
- Pranon dhe jep feedback profesional dhe konstruktiv në përmirësimin e punës;
- Planifikon burimet (financiare, njerëzore dhe materiale) e nevojshme për proceset e punës sipas projektit;
- Planifikon dhe menaxhon e kohës së nevojshme për realizimin e detyra në mënyrë efikase;
- Përdor asete digjitale të gatshme nga platforma tregtare në projekte multimediale sipas kërkesës për të përshpejtuar procesin e punës;
- Përzgjedh materialet e duhura sipas karakteristikave teknike të projektit;
- Kontrollon cilësinë e materialeve para përdorimit në përputhje me specifikimet e projektit;
- Përzgjedh mjetet e punës sipas funksioneve përkatëse dhe kërkesave të projektit;
- Mirëmban mjetet dhe pajisjet pas përdorimit sipas manualeve përkatëse dhe planit të punës;
- Monitoron dhe modifikon planifikimin në rast ndryshimesh në projekt sipas rastit;
- Raporton devijimet nga plani dhe propozimet e korrigjimit sipas rastit;
- Organizon vendin e punës sipas parimeve ergonomike;
- Verifikon saktësinë e të dhënave përpara përgatitjes finale të raportit;
- Përgatit raport teknik të saktë dhe profesional duke përdorur të dhënat e mbledhura;
- Ruan, mirëmban dhe administron në mënyrë korrekte dokumentacionin dhe arkivën e organizatës, duke siguruar gjurmueshmëri, transparencë dhe ruajtjen e historikut institucional.

NjN-19-IV-0394-25 Pajisjet kompjuterike dhe komponentët

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë sistemet kryesore TIK në funksion të multimedias.
2. Të përshkruajë legjislacionin në fuqi për TIK;
3. Të përshkruajë pajisjet kompjuterike, funksionin dhe ndërtimin e tyre.;

4. Të përshkruajë komponentët e pajisjeve kompjuterike;
5. Të përshkruajë parametrat teknikë të pajisjeve dhe komponentëve.
6. Të shpjegojë teknikat e instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve kompjuterike.
7. Të shpjegojë teknikat e instalimit dhe konfigurimit të komponentëve kompjuterik.
8. Të përshkruajë defektet e thjeshta dhe mënyrat e identifikimit të tyre.
9. Të përshkruajë teknikat dhe mjetet e testimit të pajisjeve TIK.
10. Të dallojë sistemet e operimit, tipet dhe funksionet e tyre;
11. Të përshkruajë programet aplikative, llojet, instalimin, konfigurimin dhe përdorimin e tyre.
12. Të shpjegojë teknikat e përditësimit (update), backup, restore.
13. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të planit të mirëmbajtjes.
14. Të interpretojë manualët teknike të përdorimit.
15. Të shpjegojë teknikat e identifikimit, zgjidhjes apo delegimit të problemeve.
16. Të përshkruajë teknikat e shfrytëzimit optimal të resurseve TIK për procese multimediale.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin, standardet dhe rregulloren e organizatës në fushën e TIK.
2. Të përdorë pajisjet dhe programet TIK në funksion të multimedias.
3. Të kryejë instalime dhe konfigurime të pajisjeve hardware.
4. Të kryejë instalime dhe konfigurime të software.
5. Të riparojë defektet e thjeshta në pajisje dhe sisteme TIK.
6. Të mirëmbajë pajisjet dhe sistemet e thjeshta TIK.
7. Të kryejë monitorim dhe raportim të ecurisë së punëve.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor sistemet kryesore TIK në funksion të multimedias sipas nevojës;
- Zbaton me përpikmëri legjislacionin në fuqi të fushës së TIK.
- Përzgjedh pajisjet kompjuterike sipas karakteristikave teknike dhe funksionalitetit;
- Përzgjedh sistemet e operimit sipas karakteristikave teknike dhe funksionalitetit;
- Specifikon parametrat teknikë të pajisjeve dhe komponentëve bazuar në kërkesat e procesit të punës dhe udhëzimeve.
- Përdor pajisje kompjuterike me qëllim rritjen e rendimentit në punë sipas manualeve teknike;
- Përdor lloje të ndryshme të programeve aplikative bazuar në funksionalitetet e tyre specifike sipas manualit të përdorimit;
- Kryen instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve kompjuterike bazuar në nevojat teknike, manualët dhe rregulloren e brendshme.
- Kryen instalimin dhe konfigurimin e komponentëve kompjuterikë sipas kërkesave teknike dhe manualit të servisit.
- Identifikon saktë defektet e thjeshta, anomalitë e shfaqura dhe shkaqet e tyre;
- Kryen riparim ose zëvendësim të komponentëve dhe pajisjeve kompjuterike në rast defekti apo nevoje për përmirësime të performancës sipas manualeve;

- Teston pajisjet TIK sipas nevojës duke përdorur teknika specifike dhe efektive.
- Përditëson sistemet hardware dhe software (update) sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Ruan të dhënat në mënyrë të sigurt sipas rregullores dhe udhëzimeve teknike të procedurave specifike (backup).
- Rikthen të dhënat në mënyrë të sigurt në rast të humbjes apo dëmtimit (restore).
- Zbaton planin e mirëmbajtjes sipas rregullores së brendshme dhe manualeve të shërbimit;
- Deleton problematika të pazgjdhura sipas hierarkisë dhe rregullores duke dhënë informacione të sakta mbi statusin e procesit.
- Shfrytëzon në mënyrë optimale kapacitetin e burimeve TIK në dispozicion për procese multimediale, duke përdorur teknika bashkëkohore (CPU, GPU, RAM, ROM etj.).

NjN-19-IV-0395-25 Bazat e rrjetit të komunikimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë konceptin e rrjetit të komunikimit dhe rëndësinë e tij në shkëmbimin e informacionit;
2. Të përshkruajë llojet e rrjeteve sipas shtrirjes gjeografike (LAN, MAN, WAN) dhe karakteristikat kryesore të secilit;
3. Të shpjegojë komponentët bazë të një rrjeti (router, switch, server, klient, kablo, access point);
4. Të dallojë tipologjitë e rrjetit (bus, star, ring, mesh) dhe avantazhet/disavantazhet e tyre;
5. Të përshkruajë llojet e transmetimit të të dhënave (simplex, half-duplex, full-duplex);
6. Të dallojë llojet e medias së transmetimit (kablo bakri, fiber optike, vale radio) dhe përdorimin e tyre;
7. Të shpjegojë parimet e adresimit në rrjet (MAC address, IP address, subnet);
8. Të përshkruajë klasat dhe tipet e adresave IP (IPv4, IPv6, Private, Publike, Statike, Dinamike);
9. Të dallojë ndarjet e adresave IP në nënrrjete (Subnet);
10. Të përshkruajë modelin OSI dhe TCP/IP, ndryshimet midis tyre;
11. Të përshkruajë konceptet e VLAN, Trunk, Access dhe rëndësinë e tyre;
12. Të shpjegojë procesin e konfigurimit bazë të një rrjeti lokal dhe rëndësinë e mirëmbajtjes së tij.
13. Të shpjegojë mënyrat e instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve kryesore të rrjetit;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë rrjetin e komunikimit për shkëmbimin e informacionit;
2. Të përdorë komponentët bazë të një rrjeti (router, switch, server, klient, kablo, access point);
3. Të përdorë topologjitë e rrjetit (bus, star, ring, mesh) sipas avantazheve të tyre;
4. Të konfigurojë rrjetin për transmetimin e të dhënave (simplex, half-duplex, full-duplex);
5. Të përdorë kanalet e transmetimit (kablo bakri, fiber optike, vale radio);
6. Të konfigurojë adresat në rrjet (MAC address, IP address, subnet);
7. Të dallojë klasat dhe tipet e adresave IP (IPv4, IPv6, Private, Publike, Statike, Dinamike);
8. Të llogarisë ndarjet e adresave IP në nënrrjete (Subnet);
9. Të konfigurojë VLAN, Trunk, Access, sipas kërkesës;

10. Të konfigurujë saktë rrjetin lokal të pajisjeve në përdorim.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor rrjetin e komunikimit për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesave;
- Përdor komponentët bazë të një rrjeti (router, switch, server, klient, kablo, access point) sipas topologjisë së rrjetit;
- Konfiguron transmetimin e të dhënave (simplex, half-duplex, full-duplex), sipas llojit përkatës;
- Përdor kanalet e transmetimit (kablo bakri, fiber optike, vale radio) sipas llojit të pajisjeve;
- Konfiguron adresat në rrjet (MAC address, IP address, subnet), sipas kërkesës;
- Llogarit me saktësi ndarjet e adresave IP në nënrrjete (Subnet) sipas udhëzimeve;
- Konfiguron saktë VLAN, Trunk, Access, sipas kërkesës;
- Konfiguron saktë rrjetin lokal të pajisjeve në përdorim, sipas kërkesës.

NjN-19-IV-0396-25 Bazat e programimit në web dhe sistemet e menaxhimit të përmbajtjes

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përkufizojë çfarë është një faqe web dhe strukturën e saj.
2. Të përshkruajë hapat e ndërtimit të një faqe web.
3. Të përshkruajë elementët bazë të një faqe web dhe rolin e HTML, CSS dhe JavaScript.
4. Të shpjegojë strukturën, elementet bazë dhe përdorimin e një faqeje HTML;
5. Të shpjegojë teknikat e CSS dhe përdorimin e tij për ndryshimin dhe stilizimin e pamjes së elementeve;
6. Të përkufizojë çfarë është një CMS (sistem i menaxhimit të përmbajtjes) dhe përdorimet e tij;
7. Të përshkruajë procesin e krijimit të përmbajtjes bazë në një CMS (WordPress etj.);
8. Të përshkruajë procesin e modifikimit të përmbajtjes bazë të një CMS (WordPress etj.);
9. Të shpjegojë opsionet për ndryshimin e pamjes së faqes në një CMS (themes, plugin);
10. Të krahasojë rolet dhe funksionet e përdoruesve në një CMS;
11. Të përshkruajë procesin e publikimit të përmbajtjes në një CMS, duke përfshirë artikuj, faqe dhe media.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përcaktojë funksionin e një faqeje web dhe strukturën e saj.
2. Të zbatojë hapat e ndërtimit të një faqeje web.
3. Të identifikojë elementët bazë të një faqeje web dhe rolin e HTML, CSS dhe JavaScript.
4. Të krijojë strukturën e një faqeje HTML dhe elementet bazë;
5. Të përdorë elementët bazë të një faqeje HTML sipas funksionit të tyre.
6. Të modifikojë pamjen e elementeve duke përdorur CSS;
7. Të zbatojë rregullat bazë për stilizim me CSS (class, id, font, ngjyra).
8. Të përcaktojë funksionin e një CMS dhe përdorimet e tij.
9. Të krijojë përmbajtje bazë në një CMS (WordPress etj.).

10. Të modifikojë përmbajtjen bazë në një CMS (WordPress etj.).
11. Të për zgjedhë opsionet për ndryshimin e pamjes së faqes në një CMS (themes, plugins).
12. Të përcaktojë rolet dhe funksionet e përdoruesve në një CMS.
13. Të publikojë përmbajtje në një CMS, përfshirë artikuj, faqe dhe media.

Kriteret e vlerësimit:

- Përcakton funksionin dhe strukturën e një faqeje web duke identifikuar saktë pjesët përbërëse.
- Zbaton hapat e ndërtimit të një faqeje web sipas projektit;
- Identifikon elementët bazë të web-it dhe rolin e HTML, CSS dhe JavaScript sipas funksionit të tyre në procesin e zhvillimit.
- Përcakton strukturën bazë të dokumentit HTML duke përdorur në mënyrë të saktë tag-et kryesore.
- Përdor elementët bazë të HTML sipas funksionit dhe qëllimit të tyre në faqen web.
- Zbaton rregullat bazë të CSS për të modifikuar pamjen e elementeve sipas kërkesave.
- Përzgjedh dhe aplikon CSS (class, id) rregullat e stilizimit në përputhje me standardet.
- Krijon përmbajtje bazë në CMS (artikuj, faqe) sipas udhëzimeve funksionale.
- Modifikon përmbajtjen në CMS sipas kërkesave të strukturës dhe dizajnit.
- Përzgjedh opsionet e ndryshimit të pamjes në CMS duke përdorur themes dhe plugins sipas nevojave të projektit.
- Përcakton rolet dhe funksionet e përdoruesve në CMS duke specifikuar saktë përgjegjësitë e tyre.
- Publikon përmbajtje në CMS (artikuj, faqe, media) sipas procedurave të platformës.

NjN-19-IV-0397-25 Sistemet e operimit dhe programet aplikative

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë konceptin e Sistemit të Operimit dhe rëndësinë e tij si ndërfaqe midis hardware dhe programeve aplikative.
2. Të përshkruajë funksionet kryesore të Sistemit të Operimit: menaxhimi i proceseve, memories, pajisjeve I/O dhe skedarëve.
3. Të dallojë llojet kryesore të Sistemit të Operimit (Windows, Linux/Unix, macOS, Android, iOS) dhe tipet e tyre (Server, Desktop, etj).
4. Të shpjegojë strukturën e sistemit të skedarëve dhe konceptet bazë (Direktoritë, skedarët, “pathet” etj.).
5. Të përshkruajë mjetet bazë të diagnostikimit dhe mirëmbajtjes së Sistemit të Operimit.
6. Të përshkruajë mjetet bazë të diagnostikimit dhe mirëmbajtjes në ndërfaqen e komandave (CLI) dhe ndërfaqen grafike (GUI);
7. Të klasifikojë programet aplikative sipas funksionit dhe veçorive;
8. Të dallojë mënyrat e licencimit të Sistemit të Operimit dhe programeve aplikative. (Open Source, Proprietary, Freeware, Shareware);
9. Të shpjegojë procesin e instalimit, çinstalimit dhe përditësimit të Sistemit të Operimit dhe programeve aplikative.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë Sistemit të Operimit për kryerjen e detyrave;
2. Të organizojë mjedisin e punës të sistemit operativ në mënyrë efektive;
3. Të përdorë mjetet bazë të diagnostikimit dhe mirëmbajtjes në ndërfaqen e komandave (CLI) dhe ndërfaqen grafike (GUI);
4. Të përzgjedhë programet aplikative sipas funksionit dhe veçorive;
5. Të përzgjedhë Sistemin e Operimit dhe programet aplikative bazuar në mënyrat e licensimit (Open Source, Proprietary, Freeware, Shareware);
6. Të kryejë instalimin dhe konfigurimin e programeve aplikative në funksion të proceseve të punës;
7. Të çinstalojë programet aplikative të panevojshme;
8. Të përditësojë Sistemin e Operimit dhe programet aplikative;

Kriteret e vlerësimit

- Përdor në mënyrë efektive funksionalitetet kryesore të një Sistemi Operimi të zgjedhur (p.sh., Windows/Linux) për kryerjen e detyrave.
- Kryen instalimin dhe konfigurimin e programeve aplikative në funksion të proceseve të punës duke vlerësuar përshtatshmërinë me infrastrukturën ekzistuese;
- Kryen çinstalimin e sigurt të programeve aplikative sipas rregulloreve përkatëse;
- Konfiguron saktë mjedisin e punës (desktop-in, opsionet e rrjetit, printerët) të Sistemit të Operimit sipas manualeve përkatëse;
- Përzgjedh mjete standarde të shërbimeve të Sistemit të Operimit (Utilities) për të monitoruar performancën dhe për të zgjidhur problemet bazë të sistemit sipas llojit të procesit;
- Kryen përditësimet (updates) të sistemit dhe aplikacionit në kohën e duhur për të siguruar funksionimin optimal dhe sigurinë sipas procedurës përkatëse.

NjN-19-IV-0398-25 Konceptimi i projektit në multimedia

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të interpretojë brief-in e projektit duke identifikuar qëllimin, objektivat, audiencën dhe kërkesat e klientit;
2. Të përshkruajë metodat cilësore dhe sasiore të analizimit të të dhënave të projektit;
3. Të vlerësojë realizueshmërinë teknike të projektit duke analizuar burimet, mjetet, kohën dhe kufizimet;
4. Të krahasojë referencat dhe benchmark-et për të vlerësuar standardet e industrisë;
5. Të shpjegojë funksionet bazë të marketingut dhe rolin e tyre në projektet multimediale;
6. Të nënvizojë rëndësinë e përshtatjes së mesazhit në varësi të platformës, audiencës dhe qëllimit komunikues;
7. Të klasifikojë kategoritë e projekteve multimediale sipas fushave të përdorimit;
8. Të shpjegojë elementët përbërës multimedial dhe mënyrën e kombinimit të tyre (tekst, imazh, tingull, animacion, video);

9. Të përshkruajë procesin e konceptimit të një projekti dhe parimet e storytelling-ut vizual;
10. Të dallojë teknologjitë dhe platformat multimediale sipas përdorimit të tyre teknik dhe krijues;
11. Të argumentojë alternativa të mundshme kreative ose teknike kur paraqiten kufizime të projektit;
12. Të shpjegojë teknikat kryesore të prezantimit të konceptit (vizual, verbal, digjital) për klientin dhe ekipin;
13. Të përmbledhë projekt-konceptin në dokumente të strukturuar sipas standardeve profesionale;
14. Të japë shembuj të projekteve multimediale dhe karakteristikat e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të identifikojë kërkesat e klientit për realizimin e projekteve multimediale;
2. Të përdorë metodat cilësore dhe sasiore të analizimit të të dhënave për realizimin e projektit;
3. Të përcaktojë realizueshmërinë teknike të projektit duke analizuar burimet, mjetet, kohën dhe kufizimet;
4. Të përdorë parimet bazë të marketingut në zhvillimin e projektit multimedial;
5. Të përshtatë mesazhin në varësi të platformës, audiencës dhe qëllimit komunikues;
6. Të kombinojë elementët përbërës të projektit multimedial (tekst, imazh, tingull, animacion, video) bazuar në konceptin kreativ;
7. Të zhvillojë konceptin e projektit duke zbatuar parimet bazë të storytelling-ut vizual;
8. Të përzgjedhë teknologjitë dhe platformat e përshtatshme për zhvillimin e projektit;
9. Të realizojë përgatitjen dhe prezantimin e konceptit (vizual, verbal, digjital) për klientin dhe ekipin;
10. Të dokumentojë projekt-konceptin në mënyrë të strukturuar sipas standardeve profesionale.

Kritere e vlerësimit

- Identifikon kërkesat kryesore të projektit duke analizuar brief-in;
- Përdor metodat cilësore dhe sasiore të analizimit të të dhënave;
- Përdor rezultatet e analizës nga referencat dhe benchmark-et;
- Vlerëson elementët që ndikojnë në cilësinë e projekteve multimediale;
- Përcakton realizueshmërinë teknike të projektit duke analizuar burimet, mjetet dhe kohën;
- Zbaton parimet e marketingut në projektet multimediale;
- Përshtat mesazhin sipas platformës, audiencës dhe qëllimit komunikues;
- Përcakton tone-of-voice dhe stilin vizual të përshtatshëm për secilën platformë;
- Identifikon qëllimet teknike dhe komunikative të çdo kategorie projekti;
- Identifikon dhe kombinon elementët përbërës të përmbajtjes multimediale (tekst, imazh, tingull, animacion, video) sipas kërkesave të projektit;
- Zbaton parimet e storytelling-ut vizual për realizimin e projektit;
- Përzgjedh teknologjitë dhe platformat multimediale sipas përdorimit teknik dhe krijues;
- Propozon alternativa kreative ose teknike në rast kufizimesh të projektit sipas rastit.
- Prezanton konceptin kreativ në mënyrë të qartë;
- Dokumenton projektin në mënyrë të strukturuar sipas standardeve profesionale;

- Përzgjedh shembuj projektesh multimediale për t'i analizuar në mënyrë profesionale.

NjN-19-IV-0399-25 Dizajni grafik

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë bazat e historisë së zhvillimit të artit dhe dizajnit grafik;
2. Të shpjegojë parimet e estetikës në Dizajn Grafik;
3. Të përshkruajë teoritë kryesore të komunikimit vizual dhe rëndësinë e përdorimit të tyre;
4. Të rendisë elementët bazë të dizajnit (linja, forma, ngjyra, shkallë, kontrast, ritëm);
5. Të përshkruajë rëndësinë e hapësirës së bardhë;
6. Të shpjegojë teorinë e ngjyrave dhe dallimet midis RGB dhe CMYK;
7. Të përshkruajë tipografinë dhe klasifikimet e fontit;
8. Të përshkruajë layout-in dhe strukturën e një kompozimi grafik;
9. Të shpjegojë produktet e medias së printuar dhe digjitale;
10. Të përshkruajë programet për dizajn grafik (Photoshop, Illustrator, InDesign, Canva etj.) dhe përdorimin e tyre për krijimin dhe modifikimin e elementëve grafik;
11. Të përshkruajë teknikat bazë të redaktimit të imazheve dhe grafikeve;
12. Të përshkruajë procesin UX/UI dhe përdorimin e tij në dizajn digjital;
13. Të përshkruajë krijimin e identitetit vizual dhe integrimin e elementëve grafik;
14. Të shpjegojë rëndësinë e kontrastit, harmonisë dhe balancës vizuale në dizajn;
15. Të përshkruajë përdorimin e ilustrimeve, ikonave dhe elementëve grafik për komunikim efektiv të mesazhit;
16. Të shpjegojë rëndësinë e prototipave dhe testimit të dizajnit për print dhe digjital;
17. Të përshkruajë teknikat e ruajtjes së materialeve të dizajnit grafik;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të aplikojë elementët bazë të dizajnit (linja, forma, ngjyra, shkallë, kontrast, ritëm);
2. Të përdorë hapësirën e bardhë në kompozime grafike;
3. Të zgjedhë kombinimet e duhura të ngjyrave dhe sistemin RGB/CMYK;
4. Të përdorë tipografinë dhe klasifikimet e fontit në dizajn;
5. Të krijojë layout-in dhe strukturën e kompozimit grafik;
6. Të realizojë produkte të medias së printuar dhe digjitale;
7. Të përdorë programet e dizajnit grafik për krijim dhe modifikim të elementëve;
8. Të zbatojë teknikat bazë të redaktimit të imazheve dhe grafikëve;
9. Të aplikojë procesin UX/UI në dizajnin digjital;
10. Të krijojë identitet vizual duke integruar elementë grafik;
11. Të përdorë ilustrime, ikona dhe elementë grafik për komunikim vizual;
12. Të realizojë prototipa dhe testim të dizajnit për print dhe digjital;
13. Të zbatojë teknikat e ruajtjes dhe eksportimit të materialeve të dizajnit.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon elementët bazë të dizajnit duke përcaktuar funksionin e tyre vizual;
- Zbaton rregullat bazë të kompozimit vizual për krijimin e materialeve të balancuara dhe funksionale;
- Zbaton saktë parimet vizuale si: kontrasti, harmonia dhe balanca në kompozime grafike;
- Zbaton parimet e hierarkisë vizuale për organizimin e informacionit dhe drejtimin e vëmendjes së përdoruesit;
- Përdor shkallëzimin dhe proporcionin për theksimin e elementëve kryesorë në kompozim;
- Zbaton teknikat e hapësirës së bardhë sipas parimeve të kompozimit;
- Zbaton rregullat e përsëritjes dhe konsistencës vizuale për krijimin e identitetit dhe koherencës grafike;
- Zbaton rregullat e afërsisë dhe grupimit të elementëve sipas parimeve të Gestalt-it;
- Përdor teorinë e ngjyrave dhe modelet RGB/CMYK sipas mediumit të projektit;
- Përzgjedh tipografinë dhe klasifikimet e fontit në përputhje me qëllimin grafik;
- Zbaton parimin e hierarkisë tipografike për dallimin e titujve, nën-titujve dhe tekstit bazë;
- Zbaton parimet e lexueshmërisë dhe qartësisë vizuale në materialet grafike;
- Vendos layout-in dhe strukturën e kompozimit sipas rregullave të dizajnit;
- Zbaton parimin e pozicionimit (alignment) për renditjen e saktë të elementëve në layout;
- Përdor sistemin e rrjetëzimit (grid system) për ndërtimin e strukturës së qëndrueshme vizuale;
- Përzgjedh ilustrime, ikona dhe elementë grafik për komunikim efektiv të mesazhit;
- Përdor ikonografinë vizuale sipas standardeve të komunikimit grafik;
- Realizon produktet e medias së printuar dhe digjitale sipas karakteristikave të tyre;
- Përdor programet e dizajnit grafik për krijimin dhe modifikimin e elementëve vizualë sipas kërkesave;
- Zbaton teknikat bazë të redaktimit të imazheve dhe grafikëve sipas standardeve;
- Përgatit elementë të identitetit vizual sipas kërkesave të projektit;
- Përgatit prototipe për median e printuar dhe digjitale në përputhje me specifikimet;
- Zbaton teknika të UI/UX në krijimin e materialeve digjitale sipas hapave të strukturimit dhe navigimit;
- Zbaton parimet e dizajnit të përshtatshëm (responsive design) në materialet digjitale;
- Zbaton rregullat bazë të aksesueshmërisë vizuale në dizajnin grafik digjital;
- Përdor stile vizuale dhe trende bashkëkohore të dizajnit grafik në përputhje me qëllimin e projektit;
- Përzgjedh asetet digjitale nga platforma tregtare duke respektuar rëndësinë e përdorimit korrekt dhe të licencuar për dizajn grafik;
- Përzgjedh formatet e duhura të skedarëve grafikë sipas kërkesave të medias së printuar dhe digjitale;
- Zbaton parimet e përgatitjes për printim (bleed, crop marks, rezolucion) sipas kërkesave të projektit;

- Zbaton teknikat e ruajtjes së materialeve të dizajnit grafik sipas kërkesave të projektit.

NjN-19-IV-0400-25 Realizimi i animacioneve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë principet bazë të animacionit (timing, spacing, arcs, anticipation, follow-through);
2. Të shpjegojë dallimet mes animacionit 2D dhe 3D dhe fushat e përdorimit të tyre;
3. Të listojë llojet e programeve për animacione 2D (Adobe Animate, Toon Boom, After Effects etj.) dhe karakteristikat e tyre;
4. Të listojë llojet e programeve për animacione 3D (Blender, Maya, 3D Studio Max, Cinema 4D etj.) dhe karakteristikat e tyre;
5. Të përshkruajë konceptin e keyframe-it dhe rolin e tij në animacion;
6. Të shpjegojë rëndësinë e frame rate-it (fps) dhe ndikimin e tij në cilësinë e animacionit;
7. Të shpjegojë teknikat e animimit të karaktereve (rigging, skeletal animation);
8. Të përshkruajë teknikat e animimit të objekteve dhe formave;
9. Të përshkruajë teknika të modelimit, teksturimit dhe rigging i karaktereve dhe objekteve 3D dhe përdorimet e tyre;
10. Të përshkruajë teknikat e ndriçimit, rendering dhe kompozimi i skenave 3D dhe përdorimet e tyre;
11. Të shpjegojë procesin e animimit frame-by-frame;
12. Të përshkruajë teknikat e animimit të tekstit dhe tipografisë;
13. Të përshkruajë teknikat e animimit të kamerës (camera movements, angles);
14. Të shpjegojë konceptin e easing (ease-in, ease-out) dhe përdorimin e tij;
15. Të përshkruajë llojet e animacioneve sipas qëllimit (reklamues, edukativ, argëtues, shpjegues);
16. Të shpjegojë teknikat e motion graphics (animimi i grafikave, infografikave, logo-ve, elementeve UI/UX);
17. Të përshkruajë procesin e krijimit të storyboard-it për animacion;
18. Të shpjegojë teknikat e integrit të audios në animacion (sinkronizimi me zërin, muzikën, efektet);
19. Të përshkruajë rëndësinë e import/export-it të projekteve midis programeve dhe teknologjive të ndryshme;
20. Të përshkruajë formatet e eksportimit të animacioneve (MP4, GIF, MOV, WebM etj.);
21. Të dallojë specifikimet teknike të animacioneve për platforma të ndryshme (social media, web, TV);
22. Të shpjegojë teknikat e animimit të simulimeve (fizikë, grimca, fluidë);
23. Të përshkruajë rëndësinë e optimizimit të animacioneve për performance;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë llojin e animacionit 2D ose 3D;
2. Të krijojë animacione duke përdorur programe të animacionit 2D;
3. Të krijojë animacione duke përdorur programe të animacionit 3D;
4. Të krijojë animacione duke përdorur keyframe-e;

5. Të rregullojë frame rate-in për cilësi dhe rrjedhshmëri të përshtatshme të animacionit;
6. Të realizojë animim karakteresh duke përdorur rigging dhe skelet animacioni;
7. Të animojë objekte dhe forma duke përdorur teknika të përshtatshme lëvizjeje;
8. Të realizojë animacione me teknikën frame-by-frame;
9. Të animojë tekst dhe tipografi sipas parimeve të dizajnit dhe lëvizjes;
10. Të zbatojë teknika të lëvizjes dhe pozicionimit të këndeve të kamerave në animacion;
11. Të përdorë easing për lëvizje natyrale dhe të kontrolluara;
12. Të përshtatë stilin e animacionit sipas qëllimit të tij funksional;
13. Të krijojë motion graphics për logo, infografika dhe elemente UI/UX;
14. Të përgatisë storyboard funksional për një projekt animacioni;
15. Të përpunojë animacionin me audio, muzikë dhe efekte zanore;
16. Të importojë dhe eksportojë projekte midis programeve të ndryshme;
17. Të eksportojë animacione në formate të përshtatshme sipas përdorimit;
18. Të përshtatë specifikimet teknike të animacionit për platforma të ndryshme;
19. Të realizojë animacione simulimi duke përdorur fizikën, grimca dhe fluide;
20. Të optimizojë animacionet për performancë dhe ngarkesë të ulët.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton principet bazë të animacionit (timing, spacing, arcs, anticipation, follow-through) sipas standardeve të industrisë;
- Përzgjedh teknologjinë e animacionit (2D ose 3D) sipas qëllimit dhe kërkesave të projektit;
- Përdor programe për animacione 2D (Adobe Animate, Toon Boom, After Effects etj.) sipas karakteristikave teknike dhe funksionalitetit të tyre;
- Përdor programe për animacione 3D (Blender, Maya, 3D Studio Max, Cinema 4D etj.) sipas kërkesave të projektit dhe burimeve në dispozicion;
- Kryen animime duke përdorur keyframe-a sipas skenarit dhe nevojave të projektit;
- Përcakton frame rate-in (fps) sipas qëllimit të animacionit dhe platformës së publikimit;
- Zbaton teknikat e animimit të karaktereve (rigging, skeletal animation) duke respektuar principet e lëvizjes natyrore;
- Kryen animime të objekteve dhe formave sipas konceptit krijues të projektit;
- Përdor teknikën frame-by-frame për sekuenca që kërkojnë kontroll të plotë të lëvizjes;
- Animon tekst dhe tipografi duke përdorur teknika të përshtatshme për qëllimin komunikues;
- Zbaton teknikat e animimit të kamerës (camera movements, angles) për të krijuar perspektiva dinamike;
- Përdor easing (ease-in, ease-out) për të krijuar lëvizje të natyrshme dhe profesionale;
- Përzgjedh llojin e animacionit sipas qëllimit (reklamues, edukativ, argëtues, shpjegues);
- Kryen motion graphics (animimi i grafikave, infografikave, logo-ve, elementeve UI/UX) sipas specifikimeve të projektit;
- Harton storyboard për animacion duke përcaktuar sekuenat kryesore të projektit;

- Integron audio në animacion (sinkronizimi me zërin, muzikën, efektet) me saktësi kohore;
- Eksporton dhe importon projekte midis programeve të ndryshme duke ruajtur cilësinë dhe strukturën;
- Eksporton animacione në formate të përshtatshme (MP4, GIF, MOV, WebM etj.) sipas destinacionit të publikimit;
- Përshtat specifikimet teknike të animacioneve për platforma të ndryshme (social media, web, TV);
- Zbaton teknikat e animimit të simulimeve (fizikë, grimca, fluidë) sipas nevojave kreative të projektit;
- Optimizon animacionet për performancë duke balancuar cilësinë dhe madhësinë e skedarëve.

NjN-19-IV-0401-25 Realizimi i fotove

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e pajisjeve për realizimin e fotove sipas përdorimit të tyre (kamera, lente, mikrofon, ndriçim, stabilizues);
2. Të përshkruajë komponentët kryesorë të kamerës (sensor, lente, diafragmë, shutter, ISO);
3. Të shpjegojë trekëndëshin e ekspozimit (ISO, shpejtësi e shutter-it, aperturë);
4. Të përshkruajë llojet e lenteve dhe përdorimet e tyre (wide-angle, standard, telephoto, macro);
5. Të shpjegojë teknikat e fokusimit (manual, autofocus, focus peaking);
6. Të përshkruajë llojet e dritës dhe ndikimin e tyre në fotografi (natyrale, artificiale, e butë, e fortë);
7. Të shpjegojë teknikat e kompozimit fotografik (rule of thirds, leading lines, framing, symmetry);
8. Të përshkruajë konceptin e white balance dhe rëndësinë e tij;
9. Të shpjegojë formatet e skedarëve fotografikë (RAW, JPEG, PNG, TIFF, etj.) dhe dallimet e tyre;
10. Të përshkruajë llojet e fotografisë sipas qëllimit (portret, peizazh, produkt, sport, event, etj.);
11. Të shpjegojë teknikat e punës me dritë natyrale dhe flash;
12. Të përshkruajë rëndësinë e histogramit për kontrollin e ekspozimit;
13. Të shpjegojë konceptin e thellësisë (depth of field) dhe mënyrat e kontrollit të tij;
14. Të përshkruajë pajisjet shtesë fotografike (tripod, reflektor, diffuser, stabilizator);
15. Të shpjegojë teknikat e fotografimit në kushte të ndryshme drite (golden hour, blue hour, natë);
16. Të përshkruajë programet për përpunimin e fotografive (Lightroom, Photoshop, Capture One) dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
17. Të shpjegojë teknikat bazë të gradimit të ngjyrave në fotografi;
18. Të përshkruajë rëndësinë e backup-it dhe menaxhimit të bibliotekës fotografike;
19. Të shpjegojë specifikimet teknike të fotografive për media të ndryshme (print, web, social media);
20. Të përshkruajë teknikat e fotografimit HDR dhe panoramik;
21. Të shpjegojë rëndësinë e metadata-ve dhe etiketimit të fotografive.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë komponentët kryesorë të kamerës (sensor, lente, diafragmë, shutter, ISO etj.);
2. Të rregullojë ISO-n, shpejtësinë e shutter-it dhe aperturën për ekspozim korrekt;
3. Të përzgjedhë llojin e lentes (wide, standard, telephoto, macro);

4. Të aplikojë fokusimin manual ose automatik gjatë fotografimit;
5. Të përdorë teknikat zoom-in dhe zoom-out;
6. Të përdorë lloje të ndryshme drite (natyrale, artificiale, e butë, e fortë etj.);
7. Të zbatojë rregullat bazë të kompozimit fotografik;
8. Të rregullojë white balance për balancim të saktë të ngjyrave;
9. Të zgjedhë formatin e skedarit fotografik (RAW, JPEG, PNG, TIFF etj.);
10. Të realizojë fotografi portreti, peizazhi, produkti, sporti dhe eventit etj.;
11. Të përdorë histogramin për kontroll të ekspozimit;
12. Të kontrollojë thellësinë e fushës (depth of field) në fotografi;
13. Të përdorë pajisje shtesë fotografike (tripod, reflektor, diffuser, stabilizator etj.);
14. Të realizojë fotografi në golden hour, blue hour dhe gjatë natës;
15. Të përpunojë fotografi duke përdorur programe të dedikuara Lightroom, Photoshop, Capture One, etj.);
16. Të aplikojë teknika bazë të gradimit të ngjyrave;
17. Të organizojë dhe ruajë bibliotekën fotografike;
18. Të përshtatë fotografitë për print, web dhe rrjete sociale;
19. Të realizojë fotografi HDR dhe panoramike;
20. Të shtojë dhe menaxhojë metadata dhe etiketime.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor komponentët kryesorë të kamerës (sensor, lente, diafragmë, shutter, ISO) sipas nevojave të fotografimit;
- Zbaton trekëndëshin e ekspozimit (ISO, shpejtësi e shutter-it, aperturë) për të arritur ekspozim të saktë;
- Përdor teknikat zoom-in dhe zoom-out sipas objektivit të kompozicionit;
- Përzgjedh llojet e lenteve (wide-angle, standard, telephoto, macro) sipas llojit të fotografisë dhe distancës nga subjekti;
- Kryen fokusimin (manual, autofocus, focus peaking) sipas situatës dhe rezultatit të dëshiruar;
- Përzgjedh lloje të ndryshme drite (natyrale, artificiale, e butë, e fortë) duke kontrolluar cilësinë e imazhit;
- Zbaton teknikat e kompozimit fotografik (rule of thirds, leading lines, framing, symmetry) për të krijuar fotografi të balancuara;
- Rregullon white balance sipas burimit të dritës për ngjyra të sakta;
- Ruan fotografi në formate të përshtatshme (RAW, JPEG, PNG, TIFF etj.) sipas qëllimit të përdorimit;
- Kryen fotografi sipas qëllimit (portret, peizazh, produkt, sport, event etj.) duke zbatuar teknikat specifike për secilin lloj;
- Përdor histogramin për të kontrolluar ekspozimin dhe për të shmangur humbjen e detajeve;
- Kontrollon thellësinë (depth of field) sipas nevojave kompozicionale të fotografisë;

- Përdor pajisje shtesë fotografike (tripod, reflektor, diffuser, stabilizator) për të përmirësuar cilësinë e imazhit;
- Fotografon në kushte të ndryshme drite (golden hour, blue hour, natë) duke përshtatur parametrat e kamerës;
- Përpunon fotografi duke përdorur programe specifike (Lightroom, Photoshop, Capture One, etj.) sipas standardeve profesionale;
- Zbaton teknikat bazë të gradimit të ngjyrave për të krijuar atmosferë dhe stil vizual;
- Kryen backup dhe menaxhon bibliotekën fotografike sipas praktikave të organizimit profesional;
- Përshtat specifikimet teknike të fotografive sipas mediave të ndryshme (print, web, social media);
- Kryen fotografim HDR dhe panoramik duke kombinuar ekspozime të shumëfishta;
- Etiketon fotografi me metadata për të lehtësuar kërkimin dhe menaxhimin.

NjN-19-IV-0402-25 Realizimi i video-ve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë komponentët kryesorë të kamerave video dhe dallimet nga kamerat fotografike;
2. Të shpjegojë frame rate-in (24fps, 30fps, 60fps, 120fps) dhe përdorimin e tij sipas qëllimit;
3. Të përshkruajë rezolucionet video (HD, Full HD, 4K, 8K) dhe ndikimin e tyre në cilësi;
4. Të shpjegojë konceptin e bitrate dhe codec-ëve (H.264, H.265, ProRes etj.);
5. Të përshkruajë teknikat e lëvizjes së kamerës (pan, tilt, dolly, tracking, handheld);
6. Të shpjegojë teknikat e kompozimit në video (framing, headroom, lead room);
7. Të përshkruajë llojet e planeve të regjistrimit (close-up, medium shot, wide shot, extreme close-up);
8. Të shpjegojë rëndësinë e storyboard-it dhe shot list për planifikimin e xhirimeve;
9. Të përshkruajë teknikat e ndriçimit për video (three-point lighting, practical lighting);
10. Të shpjegojë pajisjet stabilizuese të imazhit gjatë regjistrimit (gimbal, steadicam, slider);
11. Të shpjegojë teknikat e regjistrimit të audios gjatë xhirimeve (mikrofona, audio levels);
12. Të përshkruajë programet e montazhit video (Premiere Pro, Final Cut Pro, DaVinci Resolve) dhe përdorimet e tyre;
13. Të shpjegojë procesin e montazhit (rough cut, fine cut, final cut);
14. Të përshkruajë teknikat e rregullimit të ngjyrave (color correction, color grading, LUTs);
15. Të shpjegojë teknikat e tranzicioneve dhe efekteve vizuale gjatë montazhit;
16. Të përshkruajë formatet e eksportimit për platforma të ndryshme (YouTube, Instagram, Televizion, etj.);
17. Të përshkruajë teknikat e miksimit dhe transmetimin drejt për se drejti të videove;
18. Të përshkruajë teknikat e xhirimit slow-motion dhe time-laps;
19. Të shpjegojë teknikat e xhirimit të intervistës dhe filmave dokumentarë;
20. Të përshkruajë rëndësinë e proxy files dhe workflow-it të optimizuar;
21. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të kamerave specifike (action cam, drone, smartglasses, etj.).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë komponentët kryesorë të kamerave video dhe kamerave fotografike;
2. Të përcaktojë frame rate-in që do të përdoret (24fps, 30fps, 60fps, 120fps) sipas qëllimit;
3. Të përcaktojë rezolucionet video (HD, Full HD, 4K, 8K) dhe ndikimin e tyre në cilësi;
4. Të përzgjedhë bitrate dhe codec-ët (H.264, H.265, ProRes etj.);
5. Të komandojë kamerën gjatë regjistrimit (pan, tilt, dolly, tracking, handheld);
6. Të kompozojë video me metodat framing, headroom, lead room;
7. Të përcaktojë llojet e planeve të regjistrimit (close-up, medium shot, wide shot, extreme close-up);
8. Të krijojë storyboard-in dhe shot-list për planifikimin e xhirimeve;
9. Të përdorë teknikat e ndriçimit për video (three-point lighting, practical lighting);
10. Të përdorë pajisjet stabilizuese të imazhit gjatë regjistrimit (gimbal, steadicam, slider);
11. Të përdorë programet e montazhit video (Premiere Pro, Final Cut Pro, DaVinci Resolve).
12. Të zhvillojë procesin e montazhit (rough cut, fine cut, final cut).
13. Të rregullojë ngjyrat e materialit të regjistruar (color correction, color grading, LUTs);
14. Të aplikojë tranzicionet dhe efektet vizuale gjatë montazhit;
15. Të eksportojë materiale në formate specifike për platforma të ndryshme (YouTube, Instagram, Televizion, etj.);
16. Të kryejë miksimin dhe transmetimin drejtpërsëdrejti të videove;
17. Të kryejë xhirimet me metodat slow-motion dhe time-lapse;
18. Të kryejë xhirimet e intervistës dhe filmave dokumentarë;
19. Të përdorë proxy files dhe workflow të optimizuar;
20. Të përdorë kamera specifike të ndryshme (action cam, drone, smartglasses, etj.).

Kriteret e Vlerësimit

- Përdor komponentët kryesorë të kamerave video duke dalluar funksionet specifike nga kamerat fotografike;
- Përcakton frame rate-in (24fps, 30fps, 60fps, 120fps) sipas qëllimit të videos dhe efektit të dëshiruar;
- Regjistron në rezolucione të përshtatshme (HD, Full HD, 4K, 8K) sipas kërkesave të projektit dhe burimeve teknike;
- Zbaton konceptin e bitrate dhe codec-ëve (H.264, H.265, ProRes etj.) për të balancuar cilësinë dhe madhësinë e skedarëve;
- Kryen lëvizje të kamerës (pan, tilt, dolly, tracking, handheld) sipas storytelling-ut dhe dinamikës së tekstit;
- Zbaton teknikat e kompozimit në video (framing, headroom, lead room) për të krijuar imazhe profesionale;
- Përdor lloje të ndryshme planesh (close-up, medium shot, wide shot, extreme close-up) sipas kontekstit narrativ;
- Harton storyboard dhe shot list për planifikimin e xhirimeve duke organizuar procesin e prodhimit;

- Zbaton teknikat e ndriçimit për video (three-point lighting, practical lighting) për të kontrolluar atmosferën e planit;
- Përdor pajisje stabilizuese (gimbal, steadicam, slider) për të krijuar lëvizje të qëndrueshme dhe profesionale;
- Regjistron audio gjatë xhirimeve (mikrofona, audio levels) duke siguruar cilësi të mirë zanore;
- Përdor programe të montazhit video (Premiere Pro, Final Cut Pro, DaVinci Resolve) sipas workflow-it të projektit;
- Kryen procesin e montazhit (rough cut, fine cut, final cut) duke ndjekur strukturën narrative;
- Zbaton teknikat e rregullimit të ngjyrave (color correction, color grading, LUTs) për të krijuar stil vizual të qëndrueshëm;
- Përdor tranzicione dhe efekte vizuale gjatë montazhit në mënyrë funksionale dhe estetike;
- Eksporton video në formate të përshtatshme sipas platformave të ndryshme (YouTube, Instagram, Televizion etj.);
- Kryen teknikat e miksimit dhe transmetimit direkt të videove sipas standardeve teknike;
- Rregjistron video me slow-motion dhe time-lapse duke përdorur frame rate dhe intervale të përshtatshme;
- Zbaton teknikat e xhirimit të intervistës dhe filmave dokumentarë duke respektuar etikën gazetareske;
- Përdor proxy files dhe workflow të optimizuar për të menaxhuar projekte me rezolucion të lartë;
- Përdor kamera specifike (action cam, drone, smartglasses etj.) sipas nevojave kreative dhe teknike të projektit.

NjN-19-IV-0403-25 Realizimi i audio-ve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë konceptet bazë të zërit (frekuencë, amplitudë, decibel, sample rate, bit depth);
2. Të shpjegojë llojet e mikrofonave (dynamic, condenser, ribbon, lavalier) dhe përdorimet e tyre;
3. Të përshkruajë teknikat e vendosjes së mikrofonave për rezultate të ndryshme;
4. Të shpjegojë konceptin e akustikës dhe trajtimin e dhomës së regjistrimit;
5. Të përshkruajë pajisjet e regjistrimit audio (audio interface, mixer, preamp, recorder);
6. Të shpjegojë programet e përpunimit audio (Audacity, Adobe Audition, Pro Tools, Logic Pro) dhe përdorimin e tyre;
7. Të përshkruajë teknikat e editing-ut audio (cutting, fading, crossfading, noise reduction) dhe përdorimin e tyre;
8. Të shpjegojë procesin e miksimit të audios (balancimi i volumeve, panning, automation);
9. Të përshkruajë efektet kryesore audio (EQ, compression, reverb, delay, limiting);
10. Të shpjegojë procesin e masterizimit dhe rëndësinë e tij;
11. Të përshkruajë formatet e skedarëve audio (WAV, MP3, FLAC, AAC, OGG) dhe dallimet e tyre;
12. Të shpjegojë teknikat e regjistrimit të voiceover-it dhe podcast-it;
13. Të përshkruajë llojet e audios sipas qëllimit (muzikë, voiceover, sound effects, ambient);

14. Të shpjegojë teknikat e krijimit të sound design për projekte multimediale;
15. Të përshkruajë rëndësinë e sinkronizimit të audios me video;
16. Të shpjegojë konceptin e normalizimit të audios (loudness normalization) për platforma të ndryshme;
17. Të përshkruajë teknikat e regjistrimit të zërit në ambient (field recording);
18. Të shpjegojë rëndësinë e monitorimit (kufje, monitorë studio) për cilësinë e punës;
19. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të platformave tregtare të aseteve digjitale të gatshme për audio;
20. Të shpjegojë specifikimet teknike të audios për media të ndryshme (radio, TV, web, cinema).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përpunojë parametrat e zërit (frekuencë, amplitudë, decibel, sample rate, bit depth);
2. Të kryejë përzgjedhjen dhe montimin e mikrofonave sipas llojit dhe përdorimit të tyre (dynamic, condenser, ribbon, lavalier);
3. Të kryejë menaxhimin e akustikës dhe trajtimin e dhomës së regjistrimit;
4. Të përdorë pajisjet e regjistrimit audio (audio interface, mixer, preamp, recorder);
5. Të përdorë programet (Audacity, Adobe Audition, Pro Tools, Logic Pro) për përpunimin e audio;
6. Të kryejë proceset e përpunimit audio (cutting, fading, crossfading, noise reduction);
7. Të kryejë procesin e miksimit të audios (balancimi i volumeve, panning, automation);
8. Të aplikojë efektet kryesore audio (EQ, compression, reverb, delay, limiting);
9. Të kryejë procesin e masterizimit të audio;
10. Të përzgjedhë formatet e skedarëve audio (WAV, MP3, FLAC, AAC, OGG);
11. Të regjistrojë voiceover dhe podcast;
12. Të krijojë sound design për projekte multimediale;
13. Të sinkronizojë audio me video;
14. Të normalizojë audio (loudness normalization) për platforma të ndryshme;
15. Të regjistrojë zërin në ambient (field recording);
16. Të monitorojë audio (kufje, monitorë studio) për rritjen e cilësisë së punës;
17. Të përcaktojë specifikimet teknike të audios për media të ndryshme (radio, TV, web, cinema).

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton konceptet bazë të zërit (frekuencë, amplitudë, decibel, sample rate, bit depth) për të kontrolluar cilësinë e regjistrimit.
- Përzgjedh llojet e mikrofonave (dynamic, condenser, ribbon, lavalier) sipas burimit të zërit dhe mjedisit të regjistrimit;
- Zbaton teknikat e vendosjes së mikrofonave për të arritur rezultate të ndryshme akustike;
- Menaxhon akustikën e dhomës së regjistrimit duke minimizuar reflektimet dhe zhurmat e padëshiruara;
- Përdor pajisje regjistrimi audio (audio interface, mixer, preamp, recorder) sipas kërkesave teknike të projektit;

- Përdor programe përpunimi audio (Audacity, Adobe Audition, Pro Tools, Logic Pro) për editing dhe mixing profesional;
- Zbaton teknikat e editimit audio (cutting, fading, crossfading, noise reduction) për të pastruar dhe strukturuar materialin;
- Kryen miksimin e audios (balancimi i volumeve, panning, automation) për të krijuar hapësirë dhe thellësi zanore;
- Përdor efektet kryesore audio (EQ, compression, reverb, delay, imiting) sipas nevojave artistike dhe teknike;
- Kryen procesin e masterizimit për të arritur standardet e publikimit profesional;
- Ruan audion në formate të përshtatshme (WAV, MP3, FLAC, AAC, OGG) sipas destinacionit;
- Regjistron voiceover dhe podcast duke siguruar qartësi dhe cilësi të lartë zanore;
- Përzgjedh llojet e audios sipas qëllimit (muzikë, voiceover, sound effects, ambient);
- Kryen sound design për projekte multimediale duke krijuar peizazh zanor koherent;
- Sinkronizon audio me video me saktësi frame-perfect;
- Zbaton normalizimin e audios (loudness normalization) për platforma të ndryshme sipas standardeve;
- Regjistron zëra në ambient (field recording) duke përdorur teknika të përshtatshme për kushtet e jashtme;
- Përdor mjete monitorimi (kufje, monitorë studio) për të vlerësuar me saktësi cilësinë e punës;
- Përshtat specifikimet teknike të audios sipas mediave të ndryshme (radio, TV, web, cinema).

NjN-19-IV-0404-25 Mediat Digjitale, Tradicionale dhe Përmbajtja

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të klasifikojë llojet e mediave digjitale sipas funksionit, platformës dhe karakteristikave teknike;
2. Të përshkruajë llojet e përmbajtjeve digjitale bazuar në qëllimin komunikues (informim, edukim, reklamim, ndërveprim);
3. Të shpjegojë trendet bashkëkohore në mediat sociale dhe ndikimin e tyre në krijimin e përmbajtjes;
4. Të dallojë formatet kryesore të postimeve në rrjete sociale dhe përdorimin e secilit në situata të ndryshme;
5. Të interpretojë udhëzimet vizuale për dimensionet, raportet dhe standardet grafike të platformave digjitale;
6. Të shpjegojë kërkesat teknike të videove dhe animacioneve (rezolucion, frame rate, bitrate, format) sipas kanalit të publikimit;
7. Të argumentojë rëndësinë e optimizimit të përmbajtjeve digjitale për pajisje të ndryshme (desktop, tablet, mobile);
8. Të dallojë elementët kryesorë të strukturës së newsletter-it (layout, tipografi, hierarchy vizuale);
9. Të përshkruajë dallimet mes mediave digjitale dhe atyre tradicionale, duke krahasuar efektin dhe përdorimin e përmbajtjes në secilën;

10. Të përmbledhë parimet kryesore të SEO vizuale dhe të optimizimit të përmbajtjes për motorët e kërkimit;
11. Të shpjegojë rregullat bazë të të drejtave të autorit, licencimit dhe përdorimit etik të materialeve multimediale;
12. Të interpretojë të dhënat analitike (reach, impressions, ctr, engagement rate) për të vlerësuar efektivitetin e përmbajtjes;
13. Të argumentojë zgjedhjen e formatit dhe platformës bazuar në audiencë, qëllim dhe kërkesat teknike;
14. Të japë shembuj përmbajtjesh të dizajnuara mirë për media digjitale;
15. Të diferencojë standardet teknike të platformave të ndryshme (Instagram, Tiktok, Youtube, Facebook, LinkedIn, Websites).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë median digjitale të përshtatshme sipas qëllimit të përdorimit;
2. Të krijojë përmbajtjen digjitale në përputhje me objektivin komunikues;
3. Të aplikojë trende aktuale të mediave sociale në krijimin e përmbajtjes;
4. Të përdorë formatin e duhur të postimit sipas platformës përkatëse;
5. Të zbatojë udhëzimet vizuale të platformave gjatë përgatitjes së materialeve;
6. Të përgatisë përmbajtje video dhe animacione sipas kërkesave teknike;
7. Të përshtatë përmbajtjen (content responsive) për desktop, tablet dhe mobile;
8. Të strukturojë newsletter-in sipas parimeve bazë të dizajnit;
9. Të përdorë media digjitale ose tradicionale sipas qëllimit të komunikimit;
10. Të aplikojë teknika bazë të SEO vizuale në përmbajtje digjitale;
11. Të përdorë materiale multimediale në përputhje me rregullat e licencimit;
12. Të shfrytëzojë të dhëna analitike për përmirësimin e përmbajtjes;
13. Të përzgjedhë formatin dhe platformën më të përshtatshme për publikim;
14. Të analizojë shembuj përmbajtjesh digjitale për frymëzim profesional;
15. Të përshtatë përmbajtjen sipas standardeve teknike të platformës.

Kriteret e vlerësimit

- Përcakton llojet e mediave digjitale sipas funksionit, platformës dhe karakteristikave teknike, në bazë të kërkesave të projektit;
- Përzgjedh llojin e përmbajtjes digjitale në përputhje me qëllimin komunikues;
- Aplikon trendet bashkëkohore të mediave sociale sipas kontekstit të përdorimit të përmbajtjes;
- Përzgjedh formatin e postimit në rrjete sociale sipas platformës dhe audiencës së synuar;
- Zbaton udhëzimet vizuale për dimensionet, raportet dhe standardet grafike sipas kërkesave të platformës digjitale;
- Zbaton kërkesat teknike të videove dhe animacioneve sipas kanalit të publikimit;
- Përshtat përmbajtjen për pajisje të ndryshme në funksion të përdorshmërisë dhe shikueshmërisë;
- Organizon strukturën e newsletter-it sipas parimeve të dizajnit dhe hierarkisë vizuale;

- Zbaton parimet bazë të SEO vizuale për optimizimin e përmbajtjes digjitale;
- Respekton rregullat e të drejtave të autorit dhe licencimit gjatë përdorimit të materialeve multimediale;
- Përdor të dhënat analitike për të vlerësuar efektivitetin e përmbajtjes digjitale;
- Përcakton formatin dhe platformën në bazë të audiencës, qëllimit dhe kërkesave teknike;
- Përzgjedh shembuj përmbajtjesh digjitale për të identifikuar praktika të mira dizajni dhe komunikimi.

NjN-19-IV-0405-25 Produkti multimedial për prodhim dhe publikim

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë karakteristikat teknike të llojeve të ndryshme të prodhimit fizik (printim digjital, offset, lazer, CNC, 3D printing);
2. Të përshkruajë llojet dhe veçoritë e mediave digjitale dhe tradicionale (platforma online, shtyp, sinjalistikë, TV, radio);
3. Të klasifikojë llojet dhe qëllimet e përmbajtjeve multimediale (promocionale, edukative, informuese, institucionale);
4. Të dallojë formatet e dokumenteve për prodhim dhe publikim (PDF/X, TIFF, PNG, AI, PSD, MP4, MOV, STL);
5. Të shpjegojë teknikat e menaxhimit të ngjyrave dhe përgatitjen për prodhim (RGB, CMYK, Pantone, spot colors);
6. Të përkufizojë termat tipike teknike të prodhimit (rezolucion, bitrate, frame rate, audio normalization, broadcast safe) dhe veçoritë e tyre;
7. Të listojë parimet e dizajnit për media tradicionale dhe digjitale (print, paketim, tabela, social media);
8. Të listojë parimet e përshtatjes multimediale (përshtatja e përmbajtjes për kanale të ndryshme);
9. Të shpjegojë metodat e optimizimit të skedarëve për publikim në rrjete sociale dhe platforma digjitale;
10. Të përshkruajë procedurat e kontrollit, përmes mostrave dhe dorëzimit të materialeve për publikim;
11. Të shpjegojë praktikat për ruajtjen e cilësisë gjatë eksportit, konvertimit dhe arkivimit;
12. Të përshkruajë konceptet e teknologjive të reja të publikimit interaktiv (AR, VR, web 3D, digital signage);
13. Të shpjegojë metodat e testimit të përputhshmërisë së formateve, kodekëve dhe dimensioneve para publikimit;
14. Të përshkruajë procedurat e kontrollit të cilësisë dhe realizimit të përmbajtjes finale;
15. Të argumentojë rëndësinë e koordinimit me operatorët e prodhimit ose departamentet e shpërndarjes dhe publikimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përgatisë produktin multimedial për prodhim fizik (printim digjital, offset, lazer, CNC, 3D printing);
2. Të përgatisë dokumentet për prodhim dhe publikim në kanale multimediale jo fizike (website, rrjete sociale, livestream, email, radio, televizion etj.);
3. Të përshtatë përmbajtjen me kanalin, teknologjinë dhe audiencën (promocionale, edukative, informuese, institucionale);
4. Të koordinojë punën me operatorët e prodhimit ose departamentet e shpërndarjes dhe publikimit me qëllim rritjen e eficiensës së procesit të punës dhe cilësisë së produktit final;
5. Të testojë funksionalitetin dhe cilësinë para dhe pas publikimit apo prodhimit.

Kriteret e Vlerësimit

- Përgatit produktin multimedial për prodhim fizik (printim digjital, offset, lazer, CNC, 3D printing) sipas kërkesave specifike të teknologjisë përkatëse;
- Përzgjedh mediat digjitale ose tradicionale (platforma online, shtyp, sinjalistikë, TV, radio) për të plotësuar qëllimet e projektit;
- Përcakton saktë qëllimin dhe grupet e interesit gjatë krijimit të materialeve multimediale (promocionale, edukative, informuese, institucionale) me synim përcjelljen e kuptueshme dhe të përshtatshme të përmbajtjes.
- Përgatit dokumentet për prodhim dhe publikim sipas formatit të përshtatshëm (PDF/X, TIFF, PNG, AI, PSD, MP4, MOV, STL);
- Zbaton teknikat dhe udhëzimet për menaxhimin e ngjyrave dhe përgatitjen për prodhim (RGB, CMYK, Pantone, spot colors);
- Përcakton saktë parametrat teknikë gjatë krijimit të produkteve multimediale (rezolucion, bitrate, frame rate, audio normalization, broadcast safe);
- Zbaton parimet e dizajnit për media tradicionale dhe digjitale (print, paketim, tabela, social media);
- Zbaton parimet e përshtatjes multimediale sipas praktikave më të mira dhe udhëzimeve specifike të kanaleve të ndryshme;
- Optimizon skedarët për publikim në rrjete sociale dhe platforma digjitale me qëllim rritjen e cilësisë dhe shmangien e problemeve në proceset pasardhëse;
- Zbaton praktikën për ruajtjen e cilësisë gjatë eksportit, konvertimit dhe arkivimit;
- Kryen prodhimin dhe përshtatjen të materialeve multimediale për teknologji specifike (AR, VR, web 3D, digital signage);
- Teston përputhshmërinë e formateve, kodekëve dhe dimensioneve me qëllim verifikimin e funksionalitetit dhe cilësisë para publikimit;
- Zbaton procedurat e kontrollit të cilësisë dhe realizimit të përmbajtjes finale;
- Koordinon punën me operatorët e prodhimit ose departamentet e shpërndarjes dhe publikimit me qëllim rritjen e eficiensës së procesit të punës dhe cilësisë së produktit final;
- Ndjek procedurat e kontrollit, përmes mostrave dhe dorëzimit të materialeve për publikim.

NjN-19-IV-0406-25 Përdorimi i IA për proceset e punës në multimedia

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rregullat e përdorimit dhe Etikës në Inteligjencën Artificiale;
2. Të përshkruajë teknikat e komandimit të të dhënave në sisteme IA (prompts);
3. Të shpjegojë teknikat e validimit të rezultateve nga IA;
4. Të përshkruajë teknikat e shfrytëzimit të bazës së të dhënave dhe burimeve online;
5. Të shpjegojë teknikat e përdorimit të moduleve IA në platformat kryesore multimediale;
6. Të shpjegojë mënyrën se si IA asiston në menaxhimin e projekteve dhe automatizimin e proceseve multimediale;
7. Të listojë përdorimet e IA për mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave;
8. Të përshkruajë përdorimet e IA për krijimin dhe përpunimin e dizajnit grafik, përmbajtjeve foto/video/audio dhe animacioneve;
9. Të përshkruajë përdorimin e IA për krijimin e mjediseve AR/VR;
10. Të përshkruajë përdorimin e IA për përmirësimin e përvojës së përdoruesit (UX);
11. Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes së mjeteve dhe platformave multimediale duke përdorur IA;
12. Të dallojë përmbajtjen e krijuar nga Inteligenca Artificiale;
13. Të listojë metodat e futjes së të dhënave në sistemin IA: tekst, audio, foto, video, etj.;
14. Të argumentojë rëndësinë e përditësimit të sistemeve dhe platformave që përdorin module IA;
15. Të klasifikojë metodat e eksportimit të produkteve finale në formate sipas nevojës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rregullat e përdorimit dhe etikës në Inteligjencën Artificiale;
2. Të përdorë teknikat e komandimit të të dhënave në sisteme IA (prompts);
3. Të realizojë validimin e rezultateve të marra nga IA;
4. Të përdorë bazën e të dhënave dhe burimet online për IA;
5. Të përdorë modulet IA në platformat kryesore multimediale;
6. Të përdorë IA për menaxhimin e projekteve dhe automatizimin e proceseve multimediale;
7. Të përdorë IA për mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave;
8. Të përdorë IA për krijimin dhe përpunimin e dizajnit grafik, përmbajtjeve foto/video/audio dhe animacioneve;
9. Të përdorë IA për krijimin e mjediseve AR/VR;
10. Të përdorë IA për përmirësimin e përvojës së përdoruesit (UX);
11. Të mirëmbajë mjetet dhe platformat multimediale duke përdorur IA;
12. Të përdorë teknikat e futjes së të dhënave në sistemin IA: tekst, audio, foto, video etj.;
13. Të përditësojë sistemet dhe platformat që përdorin module IA;
14. Të zbatojë metodat e eksportimit të produkteve finale në formate sipas nevojës nga platformat IA.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton me përpikmëri rregullat e përdorimit dhe etikës në Inteligjencën Artificiale;
- Komandon sistemet IA duke përcaktuar saktë dhe qartë kërkesat sipas praktikave më të mira të fushës (prompts);
- Verifikon nëse rezultatet e gjeneruara nga IA përputhen me komandën dhe pritshmëritë (kuptimi, vërtetësia, zbatueshmëria, integriteti, etika etj.);
- Merr informacion në mënyrë efektive nga baza e të dhënave dhe burimet online duke përdorur asistencën e sistemeve IA;
- Përdor module IA në programe dhe platforma për procese multimediale me qëllim automatizimin e proceseve dhe rritjen e efektivitetit;

- Përdor mjete IA në menaxhimin e projekteve dhe automatizimin e proceseve me qëllim uljen e kostos dhe përshpejtimin e afateve kohore;
- Përdor asistencën e sistemeve IA për mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave në kohë të shkurtër dhe në mënyrë të organizuar;
- Përpunon dizajn grafik, përmbajtje foto/video/audio dhe animacione nëpërmjet sistemeve IA duke përkthyer saktë kërkesat teknike në komanda;
- Përdor IA në krijimin dhe përshtatjen e përmbajtjes për mjedise AR/VR;
- Përdor IA për përmirësimin e përvojës së përdoruesit (UI/UX) duke analizuar performancën dhe përmirësuar interaktivitetin;
- Mirëmban mjetet dhe platformat multimediale duke automatizuar proceset e përditësimit, mbledhjes së informacioneve nëpërmjet IA;
- Vlerëson përmbajtjen e krijuar nga Inteligenca Artificiale në mënyrë logjike dhe analitike dhe bën përmirësime në rast nevojë;
- Përcakton metodën e futjes së të dhënave në sistemin IA, formatet (audio, foto, video, PDF etj.) dhe mënyrat e komandimit;
- Përditëson rregullisht sistemet dhe platformat që përdorin module IA sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Eksporton produktet finale në formate të ndryshme, sipas nevojës, nga sistemet IA.

NjN-19-IV-0407-25 Politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit

Rezultatet e të nxënimit në njohuri

1. Të përshkruajë politikat dhe procedurat e sigurisë të organizatës.
2. Të shpjegojë rëndësinë e masave parandaluese për sigurinë fizike të pajisjeve.
3. Të përshkruajë politika të sigurisë në përdorimin e harduerë-ve dhe softuerë-ve.
4. Të shpjegojë rëndësinë e shenjave të sigurisë së produktit përfundimtar (Watermark).
5. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.
6. Të shpjegojë rëndësinë e shkeljes së politikave të sigurisë dhe të drejtave të autorit.
7. Të përshkruajë legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e autorit.
8. Të shpjegojë rëndësinë e higjienës kibernetike në ambientet e punës.
9. Të shpjegojë rëndësinë e sigurisë në Sistemet e Operimit (p.sh., fjalëkalimet, llogaritë e përdoruesve, Firewalls, Antivirus) dhe masat parandaluese.
10. Të dallojë rolet dhe ndryshimet midis llogarive të Administratorit dhe Përdoruesit Standard në menaxhimin e Sistemeve të Operimit.
11. Të përshkruajë llojet e licencave dhe certifikatave të sigurisë.

Rezultatet e të nxënimit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë politikat dhe procedurat e sigurisë të organizatës.
2. Të marrë masa parandaluese për sigurinë fizike të pajisjeve sipas rregullores.
3. Të krijojë shenja sigurie të produktit përfundimtar (watermark) sipas kërkesave të projektit.
4. Të kryejë backup të punës sipas përcaktimeve të rregullores dhe projektit.
5. Të ruajë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave sipas politikave të organizatës.
6. Të raportojë shkeljen e politikave të sigurisë dhe të drejtave të autorit sipas legjislacionit.

7. Të zbatojë legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e autorit.
8. Të kujdeset për higjienën kibernetike në ambientet e punës sipas praktikave që rrjedhin nga legjislacioni përkatës.
9. Të aplikojë masat bazë të sigurisë në Sistemin e Operimit, duke vendosur fjalëkalime të sigurta dhe duke aktivizuar/konfiguruar mbrojtjen bazë të Firewall-it lokal, Antivirusit etj.
10. Të menaxhojë llogaritë e përdoruesve, duke krijuar dhe modifikuar llogari me privilegje të ndryshme (Administrator, Standard).

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton politikat dhe procedurat e sigurisë të organizatës.
- Merr masa parandaluese për sigurinë fizike të pajisjeve sipas rregullores.
- Zbaton politika të sigurisë në përdorimin e harduerë-ve dhe softuerë-ve, sipas legjislacionit përkatës.
- Krijon shenja sigurie të produktit përfundimtar (watermark) sipas kërkesave të projektit.
- Kryen backup të punës sipas përcaktimeve të rregullores dhe projektit.
- Ruan konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave sipas politikave të organizatës.
- Raporton shkeljen e politikave të sigurisë dhe të drejtave të autorit sipas legjislacionit.
- Zbaton legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e autorit.
- Kujdeset për higjienën kibernetike në ambientet e punës sipas praktikave që rrjedhin nga legjislacioni përkatës
- Aplikon masat bazë të sigurisë në Sistemin e Operimit, duke vendosur fjalëkalime të sigurta dhe duke aktivizuar/konfiguruar mbrojtjen bazë të Firewall-it lokal, Antivirusit.
- Menaxhon llogaritë e përdoruesve, duke krijuar dhe modifikuar llogari me privilegje të ndryshme (Administrator, Standard).

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë llojet e dokumentacioneve financiare dhe ligjore;
2. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të urdhrave të punës;
3. Të përshkruajë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës lidhur me aktivitetin që kryen;
4. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të qeverisjes dhe përputhshmërisë në organizatë.
5. Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
6. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së materialeve dhe të kohës së punës;
7. Të dallojë llojet e raportimeve administrative, financiare apo juridike në organizatë;
8. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve pajisjeve produkteve dhe shërbimeve;
9. Të përshkruajë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;

10. Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së një oferte për shërbimin apo produktin që ofron;
11. Të listojë mënyrat e blerjes së mjeteve, materialeve, pajisjeve, produkteve dhe shërbimeve;
12. Të përshkruajë llojet e dokumenteve për dorëzimin e produkteve/shërbimeve dhe mënyrën e përgatitjes së tyre;
13. Të përshkruajë teknikat bazë të marketingut;
14. Të përshkruajë rëndësinë e analizës së vetvetes;
15. Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
16. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë bashkëkohore për proceset e punës;
17. Të listojë mënyrat e transmetimit të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë tek bashkëpunëtorët;
18. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për llojet e panaireve dhe ekspozitave;
19. Të dallojë llojet e trajnimeve, kurseve dhe konferencave.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë përpilimin dhe arkivimin e dokumentacioneve;
2. Të zbatojë urdhrat e punës;
3. Të zbatojë kodin e punës, legjislacionin bazë të fushës lidhur me aktivitetin që kryen;
4. Të blejë materialet, pajisjet dhe shërbimet që i nevojiten;
5. Të raportojë të dhëna administrative, financiare apo juridike në biznes;
6. Të përgatisë një ofertë për shërbimin apo produktin që ofron;
7. Të zbatojë teknika të marketingut;
8. Të zhvillohet profesionalisht në karrierë;
9. Të kryejë transmetimin në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;

Kriteret e vlerësimit

- Harton saktë dokumentacione financiare dhe ligjore;
- Zbaton urdhrat e punës sipas hierarkisë;
- Zbaton kodin e punës, legjislacionin e fushës lidhur me aktivitetin që kryen;
- Përpilon dhe arkivon dokumentacionin në biznes duke zbatuar rregulloret dhe udhëzimet;
- Llogarit saktë materialet dhe kohën e punës;
- Harton raporte për të dhëna administrative, financiare apo juridike në biznes duke zbatuar legjislacionin në fuqi;
- Llogarit saktë koston e mjeteve, materialeve, pajisjeve, produkteve dhe shërbimeve;
- Gjeneron fatura financiare sipas ofertës dhe legjislacionit në fuqi;
- Përgatit oferta për shërbimin apo produktin që ofron;
- Kryen blerje të mjeteve, materialeve, pajisjeve, produkteve dhe shërbimeve sipas planifikimit;
- Përpilon saktë dokumentet për dorëzimin/shoqërimin e produkteve/shërbimeve sipas kërkesave;
- Përdor teknikat bazë të marketingut sipas praktikave më të mira;
- Zbaton rregulloret e qeverisjes dhe përputhshmërisë në organizatë;

- Kryen analizën e vetvetes në mënyrë efektive;
- Përdor metodat e zhvillimit profesional sipas praktikave më të mira;
- Përdor metodat e zhvillimit të karrierës sipas praktikave më të mira;
- Përdor teknologji bashkëkohore të përshtatshme për proceset e punës;
- Transmenton në kohë dhe qartë tek bashkëpunëtorët njohuritë.
- Aplikon teknika të reja në punë me qëllim rritjen e rendimentit;
- Viziton panairë dhe ekspozita bazuar në objektivat personale dhe të organizatës;
- Ndjek trajnime, kurse dhe konferenca të përshtatshme me profilin e vet.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të Kodit të etikës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për zhvillimet e reja të ditës;
3. Të shpjegojë parimet e punës në grup;
4. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
5. Të përshkruajë teknikat e negocimit, menaxhimit të mosmarrëveshjeve, zgjidhjes së problemeve dhe konceptin e mendimit kritik;
6. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
8. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
9. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj;
10. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së të dhënave konfidenciale të klientit/organizatës;
11. Të përshkruajë teknikat e menaxhimit të stresit dhe punës nën presion.
12. Të përshkruajë konceptin e menaxhimit të të dhënave personale (GDPR).

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë Kodin e Etikës;
2. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
3. Të bashkëpunojë me kolegët, eprorët dhe klientët.
4. Të menaxhojë stresin dhe ngarkesën në punë.
5. Të përdorë terminologji profesionale gjatë komunikimit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton Kodin e Etikës.
- Informohet për zhvillimet e reja të ditës.
- Zbaton parimet e punës në grup me qëllim nxitjen e bashkëpunimit.
- Komunikon në mënyrë efektive për procesin e punës dhe metodat e tij.
- Komunikon në mënyrë verbale dhe jo verbale sipas rregullores.
- Zgjidh problemet dhe mosmarrëveshjet duke zbatuar konceptin e mendimit kritik.
- Bashkëpunon në mënyrë të organizuar me kolegët bazuar në rolin e tyre në veprimtarinë profesionale.
- Përdor teknologji bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit sipas rregullores.

- Përdor terminologji profesionale të përshtatshme për fushën e veprimtarisë.
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.
- Zbaton parimet e standardit të menaxhimit të të dhënave personale (GDPR).
- Zbaton teknikat e menaxhimit të stresit dhe punës nën presion me qëllim uljen e mbingarkesës personale dhe profesionale.

NjN-19-IV-0408-25 Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
2. Të interpretojë manualët e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të shpjegojë mjetet dhe procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të përshkruajë masat mbrojtëse në varësi të punës që do kryhet për mbrojtjen nga rënia nën tension nga rryma elektrike, nga rrezatimi apo ndotja akustike;
5. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikës në mjediset e punës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të rregullave gjatë punës në lartësi;
7. Të shpjegojë sinjalistikat në mjedisin e punës;
8. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
9. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të kutisë së MZSH;
10. Të përshkruajë masat përkatëse që duhen marrë gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
11. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
12. Të listojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve;
13. Të përshkruajë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
14. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
15. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik sipas standardeve dhe legjislacionit shqiptar;
2. Të zbatojë manualët e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti duke përdorur mjetet dhe procedurat e duhura;
4. Të zbatojë masat mbrojtëse në varësi të punës që do kryhet për mbrojtjen nga rënia nën tension nga rryma elektrike, nga rrezatimi apo ndotja akustike;
5. Të respektojë rregullat gjatë punës në lartësi;
6. Të zbatojë sinjalistikat në mjedisin e punës;
7. Të zbatojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
8. Të përdorë kutinë e MZSH4;
9. Të përdorë solucionet me përmbajtje kimike duke marrë masat përkatëse;
10. Të zbatojë rregulloren për ruajtjen e mjedisit të qëndrueshëm;
11. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve;
12. Të depozitojë mbetjet duke zbatuar rregulloret përkatëse;
13. Të kryejë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit duke zbatuar rregullat e sigurisë;
14. Të zbatojë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton standardet dhe legjislacionin shqiptar të rregullave të sigurimit teknik;
- Zbaton saktë manualët e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Zbaton masat mbrojtëse në varësi të punës që do kryhet për mbrojtjen nga rënia nën tension nga rryma elektrike, nga rrezatimi apo ndotja akustike;
- Respekton rregullat gjatë punës në lartësi;
- Zbaton saktë sinjalistikat në mjedisin e punës;
- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Përdor saktë pajisjet e MZSH;
- Merr masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Zbaton praktika të ruajtjes së mjedisit të qëndrueshëm;
- Kryen ndarjen e mbetjeve sipas rregullave të mbrojtjes së mjedisit;
- Zbaton saktë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
- Zbaton rregullat për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në multimedia	3	NjN-19-IV-0393-25
2	Pajisjet kompjuterike dhe komponentët	5	NjN-19-IV-0394-25
3	Bazat e rrjetit të komunikimit	5	NjN-19-IV-0395-25
4	Bazat e programimit në web dhe sistemet e menaxhimit të përmbajtjes	4	NjN-19-IV-0396-25
5	Sistemet e operimit dhe programet aplikative	3	NjN-19-IV-0397-25
6	Konceptimi i projektit në multimedia	6	NjN-19-IV-0398-25
7	Dizajni grafik	10	NjN-19-IV-0399-25
8	Realizimi i animacioneve	11	NjN-19-IV-0400-25
9	Realizimi i fotove	6	NjN-19-IV-0401-25
10	Realizimi i video-ve	9	NjN-19-IV-0402-25

11	Realizimi i audio-ve	6	NjN-19-IV-0403-25
12	Media digjitale, tradicionale dhe përmbajtja	6	NjN-19-IV-0404-25
13	Produkti multimedial për prodhim dhe publikim	6	NjN-19-IV-0405-25
14	Përdorimi i IA për proceset e punës në multimedia	7	NjN-19-IV-0406-25
15	Politikat e sigurisë dhe të drejtat e autorit	4	NjN-19-IV-0407-25
16	Sipërmarrje dhe edukim karriere	3	NjN-23-IV-0005-24
17	Komunikimi dhe etika profesionale	3	NjN-22-IV-0006-24
18	Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit në multimedia	3	NjN-19-IV-0408-25
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësisive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikimi i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikant profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);

ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: T/4-IV-25

T - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

/ - Simboli që tregon kualifikime me kohëzgjatje 4- vjeçare

4 - Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-19-IV-0393-25**

NjN - Shkronjat tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

19 - Numri që identifikon fushën e Njësive të të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësive të të Nxënit në strukturën e KSHK

0393 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit

Akronime

TIK – Teknologji e Informacionit dhe e Komunikimit

CPU – Central Processing Unit (Njësia Qendrore e Përpunimit)

GPU – Graphics Processing Unit (Njësia e Përpunimit Grafik)

RAM – Random Access Memory

ROM – Read-Only Memory

HD – High Definition (Rezolucion i Lartë)

OSI – Open Systems Interconnection

TCP/IP – Transmission Control Protocol / Internet Protocol

VLAN – Virtual Local Area Network (Rrjet Lokal Virtual)

CMS – Content Management System (Sistem Menaxhimi përmbajtjeje)

CLI – Command Line Interface (Ndërfaqe me Linjë Komandash)

GUI – Graphical User Interface (Ndërfaqe Grafike)

UX – User Experience (Përvoja e Përdoruesit)

UI – User Interface (Ndërfaqe e Përdoruesit)

SEO – Search Engine Optimization (Optimizim për Motorët e Kërkimit).

AR – Augmented Reality (Realitet i Shtuar)

VR – Virtual Reality (Realitet Virtual)

IA – Inteligjencë Artificiale